



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E MJEDISIT  
MINISTRI

Nr. 6849 Prot.

Tiranë, më 24.11.2015

URDHËR

Nr 750, date 24.11, 2015

PER  
MIRATIMIN E PLANIT TË MENAXHIMIT TË PARKU KOMBËTAR TË  
EKOSISTEMIT NATYROR DETAR PRANË GADISHULLIT TË KARABURUNIT DHE  
ISHULLIT TË SAZANIT

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 15 e 16 pika c, të ligjit nr. 8906, datë 06,06,2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit" të përgatitur në kuadër të Projektit "Përmirësimi i mbulimit dhe efikasitetit të menaxhimit të zonave të mbrojtura detare dhe bregdetare" të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) të financuar nga Fondi Global për Mjedisin (GEF) dhe bashkë-financuar nga Ministria e Mjedisit dhe UNDP, sipas tekstit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e planit të menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit" ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me strukturat përkatëse të pushtetit vendor, ministrive të linjës si dhe palet e tjera të interesuara.
3. Për të mbikqyrur zbatimin e planit të menaxhimit ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut.
4. Bazuar në dispozitat e ligjit 8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura" të ndryshuar, plani i menaxhimit të Parkut Kombëtar të Ekosistemit Natyror Detar pranë Gadishullit të Karaburunit dhe Ishullit të Sazanit" të përfshihet e të integrohet në politikat, planet, programet dhe veprimtaritë që lidhen me to si dhe në vendimmarrjet e nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor.

5. Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar të përcjellë Planin e Menaxhimit në institucionet, zbatimin e të cilit lidhet me fushat e përgjegjësisë shtetërore të tyre.
6. Plani i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan” të publikohet në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Mjedisit.
7. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Komiteti i Menaxhimit të Parkut Kombëtar Detar “Karaburun-Sazan”, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Mjedisit dhe Jetesimit të Prioriteteve, Drejtoria e Integritit dhe Koordinimit të Projekteve, Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

